



NDËRMARRJA
PUBLIKE
BANESORE

Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 672, e-mail: info@npbanesore.com
www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit 04-03/1106/2

Data 04.07.2023

Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. në Prishtinë, në bazë të dispozitave të nenit 26, paragrafi 26.5, të Statutit të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A., nr. 01-797/1, dt. 03.08.2022, në bazë të nenit 6, paragrafi 5, pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 Kryeshefi Ekzekutiv merr këtë:

VENDIM

- I. ANULOHET Konkursi i Publikuar me datë 13.06.2023 për pozitën Zyrtar/e i/e Lartë për Autopark (1) pozitë në Ndërmarrjen Publike Banesore.
- II. Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.07/2017, i datës 19.10.2017, shpallja e radhës për këtë pozitë do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- III. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. Prishtinë ka shpallur konkurs me datë 13.06.2023 për pozitën Zyrtar/e i/e Lartë për Autopark (1) pozitë, bazuar në nenin 6, paragrafi 5, pika 5.1, anulimi i konkursit bëhet nëse së paku 3 kandidatë nuk i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017, Kryeshefi Ekzekutiv vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

T'i dorëzohet :

- Kryeshefit Ekzekutiv,
- Divizionit të Burimeve Njerëzore,
- Arkivës


Arton Berisha
Kryeshef Ekzekutiv

